



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të përbashkët të shoqërisë Trasporti Romagna S.p.A nga shoqëritë Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A dhe FIS S.r.l..

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 531 prot. i AK, datë 02.09.2022 “Përqendrimi nëpërmjet përfimit të kontrollit mbi Trasporti Romagna S.p.A, nga ana e Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A dhe FIS S.r.l – Njoftim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”

Referuar “Marrëveshje shit-blerjeje e propozuar” të depozituar, palët në transaksion janë:

Blerësi: Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A , një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian me objekt aktiviteti: Ofrimin e shërbimit të administrimit të aktiveve kolektive të kursimeve, i cili kryhet nëpërmjet administrimit të organeve alternative të investimeve kolektive të kursimit dhe rreziqeve përkatëse, si dhe administrimi dhe tregtimi i tyre, dhënia e shërbimeve të menaxhimit të portofoleve, ofrimi i shërbimeve ndihmëse, si dhe kryerja e veprimtarive përkatëse dhe instrumentale etj. Eurizon Capital Real Asset S.G.R S.p.A vepron në emër dhe për llogari të Eurizon Capital S.G.R S.p.A, e cila është shoqëria kontrolluese e Divizionit të Menaxhimit të Aseteve të Intesa SanPaolo Group. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Shitësi 1: Neuberger Berman AIFM S.A.R.L, administrues i fondeve alternative të investimeve i themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Luksemburgut.

Shitësi 2: Unigrains Developpement S.A- Dega në Itali, administrues i fondit të themeluar dhe që funksionon sipas ligjeve të Francës.

Shitësi 3: Intesa Sanpaolo S.p.A, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit italian. Objekti i shoqërisë është marrja e depozitave dhe kryerja e të gjitha formave të aktiviteteve të kredive, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përmes filialeve të saj. Shoqëria mund të ofrojë të gjitha shërbimet bankare dhe financiare, duke përfshirë krijimin dhe menaxhimin e skemave të pensioneve të hapura dhe të mbyllura, si dhe të kryejë çdo transaksion tjetër që është thelbësor për shoqërinë.

Shitësi 4: FIS S.r.l, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian,

me objekt aktiviteti: Marrjen, heqjen, si dhe administrimin dhe menaxhimin në vetvete me anë të një investimi të qëndrueshëm dhe jo me anë të vendosjes së pjesëmarrjeve në shoqëri dhe subjekte të tjera të krijuara ose që do të krijohen, financimin dhe koordinimin teknik dhe financiar të shoqërive ose subjekteve në të cilat ajo merr pjesë, ofrimin e shërbimeve në fushën financiare, administrative teknike dhe tregtare për kompanitë e investuara etj.

FIS S.r.l nuk është aktive në Shqipëri.

Shoqëria Target: Trasporti Romagna S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti: Shërbimin e transportit me automjete të sendeve dhe mallrave për llogari të palëve të treta; sigurimin, menaxhimin dhe zbatimin e logjistikës dhe transporteve intermodale në Itali dhe jashtë shtetit; menaxhimin e terminaleve portuale, aeroportuale, hekurudhore etj.

Trasporti Romagna S.p.A nuk është aktive në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.